



P Z A P
I P Ž P

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.73/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Bujar Muzaqi kryesues, Kujtim Pasuli dhe Hajriz Hoti anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Pejë, ka paraqitur ankesë kundër Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, për shkak të përdorimit të gjuhës së urrejtjes, gjatë fushatës zgjedhore, për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 22.01.2025, merr këtë:

V E N D I M

I. Pranohet e bazuar ankesa e Subjektit Politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me seli në Komuna Pejë, Anr.73/2025 e datës 20.01.2025.

II. Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Komuna Pejë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, i shqiptohet dënim i gjelbër më lartësi prej 1.000,00 Euro (Njëmijë) Euro.

III. Detyrohet Subjektit Politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), me seli në Pejë, që gjobën e shqiptuar si në pikën -II-, të dispozitivit të këtij vendimi, ta paguaj në afat prej 15 ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij vendimi.

A r s y e t i m

Me datë 20.01.2025 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Subjekti Politik, Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK), me të cilën pretendon se Partia Liberale Egjiptiane (PLE), më datë. 18.01.2025, në Komunën e Pejës, përkatësisht Restorantin “Arosa” në Vitomericë ka mbajtur tubim zgjedhor me qytetarët e Pejës me fshatra. Mëtutje në ankesë theksohet se gjatë këtij tubimi, përkatësisht intervalit kohor mes orës 18:00 dhe 19:00, kryetari i Partisë Liberale Egjiptiane Veton Berisha, në fjalën e tij ndër të tjerash është shprehur: “jemi sot në ditë të rënda, ofertat janë marramendëse, ofrohen çmime, ofrohen oferta të cilat janë të pa mendume! Parashtruesi i ankesë mëtejë pretendon se si ka mundësi një parti e një komuniteti të varfér me 70%, me jetu edhe me iu dhanë oferta të tilla, ku këto oferta kanë mundur me u realizua në

komunitet për krejt këto katër vite! Në vazhdim thuhet se edhe pse është pauzu për këto katër vite, pse o dashtë me ardhë në kohë fushate tash edhe me iu ofruar oferta marramendëse. Komuniteti Egjiptian nuk do ta shes votën kësaj here o ministër, komuniteti Egjiptian ka vetëdije, gjithashtu komuniteti do ti përballojë pasurimit tënd.

Më tej në ankesë thuhet se kryetari i Partisë Liberale Egjiptiane- PLE, Veton Berisha, përmes manipulimit me tërsin e fjalëve të strukturuara në fjali dhe të transkriptuara në ankesë, duke shpifur nxjerr dy konstatime: (1) se “ministri” ka blerë vota dhe (2) se “ministri” po ofron blerje te votave, kur thotë se “...komuniteti egjiptian nuk do ta shes votën kësaj here o ministër!”. Sipas parashtruesit të ankesës, shkelësi i supozuar, me këtë veprim kanë cenuar rëndë nenin 34, paragrafi 1.11, i Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovës si dhe përbëjnë dyshime të arsyeshme për shkelje penale të mashtrimit dhe vepra penale kundër të drejtave të votimit të parapara me Kodin Penal të Republikës së Kosovës.

Si dëshmi për pretendimet e tij, paraqitësi i ankesës, ka bashkangjitur një CD, nga tubimi, pjesë e shkëputur e fjalës e cila përmban pamje dhe zë.

Më datë 21.01.2025, PZAP-i, e njoftoi subjektin politik Partisë Liberale Egjiptiane- (PLE) për ankesën e paraqitur kundër tyre, duke i dërguar kërkësë për përgjigje deri më 22.01.2025.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur më datë 22.01.2025, subjekti politik Partisë Liberale Egjiptiane- PLE ka kundërshtuar ankesën e paraqitur nga subjekti politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) dhe ka theksuar se deklaratat e tillë z. Veton Berisha i ka bë pa menduar fare emrin e asnjë ministri, edhe pse IRDK këto deklarata i ka marrë kinse Veton Berisha ka aluduar në ministrin, Elbert Krasniqi. Mëtutje në përgjigjen në ankesë theksohet se Veton Berisha në deklarimin ne tij nuk ka përmendur emrin e asnjë ministri, mirëpo edhe po të kishte përmendur faktin se ministri, Elbert Krasniqi ka blerë vota, një gjë e tillë është e provuar dhe e vërtetuar në gjykatë dhe është fakt i njohur botërisht se njerëzit nga strukturat politike të IRDK-së, me kryetar ministri Elbert Krasniqi, ku saktësisht Elvis Halimaj është dënuar me vendim gjyqësor për veprën penale të blerjes së votava dhe Veton Berisha deklarimin e tij e ka mbështetur në këto vendime të gjykatave ku në të kaluarën sipas pretenduesit në ankesë në të kaluarën janë blerë vota nga IRDK-ja, dhe mbi këtë bazë ka deklaruar “*Komuniteti Egjiptian nuk do ta shes votën kësaj here o ministër*”

Në përgjigje si provë ka përfshirë disa linqe të mediave dhe portaleve.

Sipas përgjigjes nga PLE theksohet se deklaratat tillë aspak nuk kanë të bëjnë me nxitje apo provokim në urrejtje kundër të tjerëve, për ato janë deklarata politike në kuadër të fushatës zgjedhore që nuk kanë shkaktuar ndonjë dëm apo pasojë të caktuar, nuk kanë inkurajuar dikë që të bëj ndonjë sjellje të pahjshme dhe si të tillë nuk kanë prodhuar ndonjë rezultat destruktiv apo ndonjë tension ndaj askujt dhe deklaratat e tyre nuk përbëjnë shkelje të nenit 34, paragl.11 të Ligjit NR.08/-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në republikën e Kosovës.

Në fund të përgjigjes propozojnë Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), pas analizimit të gjendjes faktike dhe administrimit të provave të refuzojë ankesën në fjalë.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, konstatoi se:

-Ankesa është e bazuar.

Paneli, pas shikimit të provave materiale, dhe dëgjimit të CD të bashkangjitur në ankesë, ku konstatohet se kryetari i subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE) , kryetari i kësaj partie Veton Berisha në raport me subjektin politik Iniciativa e Re Demokratike e Kosovës (IRDK) ka përdorur gjuhë fyeze dhe denigruese duke nxitur urrejtje ndaj këtij subjekti politik, në atë mënyrë që përderisa i ishte drejtuar elektoratit të tij në Restaurantin "Arosa" në Vitomiricë, përdorë fjalët "...jemi sot në ditë të rënda, ofertat janë marramendëse, ofrohen çmime, ofrohen oferta të cilat janë të pa mendueme...komuniteti egjiptian nuk do ta shes votën kësaj here o ministër! Komuniteti egjiptian nuk do ta shes votën kësaj here o ministër...".

Paneli, konform nenit 13 par. 6 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr. 01/2024, me datë 14.01.2025, ndërmori hetim lidhur me pretendimet e paraqitësit të ankesës dhe gjeti se të njëjtat janë të bazuara, sepse përdorimi i një gjuhe të tillë është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, me të cilën përcaktohet: "*Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjërisë si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*".

Sipas Panelit, Kodi i Mirësjelljes i detyron të gjitha subjektet politike, kandidatët, anëtarët e subjekteve dhe mbështetësit e tyre që ta respektojnë këtë kod me qëllim të krijimit të kushteve që gjatë periudhës së fushatës, veprimet e subjekteve politik të jenë në një atmosferë të tolerancës demokracisë, paqes dhe respektit për sundimin e ligjit.

Andaj Paneli gjeti se gjuha e përdorur ndaj subjektit politik IRDK, është në kundërshtim me Kodin e Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjegjësisht me dispozitat e nenit 34 LZP-së ku janë të përcaktuara veprimet e ndaluara të subjekteve politike dhe me këto veprime janë shkelur dispozitat e nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së. Në këtë rast është marrë përbazë kontekstin dhe qëllimin për të cilin është përdorur gjuha ndaj një subjekti politikë në garë, faktin që deklaratat janë bërë në miting publike, audiencën, andaj sipas Panelit përdorimi i gjuhës së tillë ndaj kundërshtarëve politikë ka për qëllim ofendimin, denigrimin dhe njëherit shihen si shprehje me ngjyrime përqmues ose nënvlerësuese. Rregullat që rregullojnë fushatën zgjedhore kërkojnë nga subjektit politike dhe përfaqësuesit e tyre të shmangin përdorimin e gjuhës fyeze, denigruese dhe urrejtëse, andaj sipas Panelit përdorimi i kësaj gjuhe në këtë rast konsiderohet si përkeqësim i klimës në të cilën duhet të zhvillohet gara zgjedhore dhe njëherit mund të rrisë tensione mes subjekteve politike.

Pretendimi në përgjigje në ankesë i subjektit politik Partia Liberale Egjiptiane (PLE), se deklarata e tillë e Kryetarit të Partia Liberale Egjiptiane (PLE) z.Veton Berisha, është bërë pa përmendur fare emrin e asnjë ministri, ky pretendim është i pa bazuar, pasi që në përgjigjen në ankesë, përfaqësuesi Partisë Liberale Egjiptiane (PLE) ndër të tjera ka deklaruar se

se Veton Berisha në deklarimin e tij nuk ka përmendur emrin e asnjë ministri, mirëpo edhe po të kishte përmendur faktin se ministri Elbert Krasniqi ka blerë vota, një gjë e tillë është provuar dhe vërtetuar në gjykatë dhe është fakti i njohur botërisht se njerëzit dhe strukturat politike të IRDK me kryetar ministrin z. Elbert Krasniqi, ku saktësisht Elvis Halimaj, është dënuar me vendim gjyqësor për veprën penale të blerjes së votave... ”.

Paneli, me rastin e vendosjes se gjobës si në dispozitiv të këtij vendimi, ka marrë parasysh të gjitha rrethanat si në vijim: natyrën e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor në fjalë, shkallën dhe peshën e shkeljes, shkeljet e Ligjeve zgjedhore në fuqi që ka bërë subjekti në fjalë në këto zgjedhje si dhe faktin që shkelja nga ky subjekt është bërë për herë të parë, njëherit subjekti politikë në fjalë nuk është përfitues i fondit për financimin e subjekteve politike përmes buxhetit të Republikës së Kosovës.

Prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, ankesën e parashtruar e konsideron të bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 paragrafi 3 i Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Përveç të cekurave më lartë Paneli, me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet tjera të përgjigjes në ankesë, mirëpo të njëjtët ishin të pabazuara, të pa qëndrueshme dhe pa bazë ligjore si në dispozitat e Ligjit për Zgjedhje, dhe si të tilla nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka Paneli, vlerësoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Nga arsyet e theksuara me lart, e në kuptim të nenit 34 pika 1.11),, nenit 118 paragraf 1 dhe nenit 120 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

A.nr. 73/2025 më datë 22.01.2025



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.